



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER IRMA BROCI  
ADRESA Nr.11, Rruga "Don  
Bosko", Kulla nr.1  
TEL: 0682041600

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1230

Nr. koleksioni: 444

Tirane më 07/06/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

\*Akti notarial përbëhet nga 5 fletë



A2024054320033453572



A202405432003345352

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 07.06.2024 (dymije e njetzet e kater), para meje Noter IRMA BROCI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.11, Rruga "Don Bosko", Kulla nr.1, u paraqit personalisht:

DHURUES: HENRYK EGETEMAYER, atësia Gerhard, shtetas Gjerman, lindur në ANSBACH dhe banues në Permet, lindur më 16/01/1966, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID gjermane nr. C84F4JF4M  
(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT: ANJA CHRISTINA SCHRADER, atësia Helmut, shtetase Gjermane, lindur në Tegernsee dhe banuese në Gjermani, me adresë Donersberg 13 91550 Dinkelsbühl, lindur më 22/05/1970, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me pasaportën gjermane nr. LG76W2JK6.

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit").

Te lartpërmendurit deklaruan se nuk kuptojnë shqip e kerkuan ndihmen e nje perkthyesi ne gjuhen angleze pasi e zoterojne kete gjuhe nga zoti Faruk Besho (mbajtes i nr. personal E20105114K)

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Baza Ligjore: Neni 761 e vijues të Kodit Civil, Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

### NENI 1

#### TË DHËNA PARAPRAKË

1. Pala Dhuruese është ortaku i vetem i shoqërisë Franz und Charly Sh.p.k. dhe zotëron një kuotë me vlerë 7.500.000 (shtatë milion e pesëqind mijë) Lekë ose 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kjo palë me vullnetin e saj të lirë e të pavesuar ka vendosur të dhurojë 50% të kuotës që zotëron në kapitalin e shoqërisë Franz und Charly Sh.p.k në favor të Pranuesit të Dhurimit ANJA CHRISTINA SCHRADER.
2. Pala dhuruese dëshiron t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit 50% të kuotave të tij dhe Pranuesi i Dhurimit dëshiron të pranojë pa ndonjë kundërshtim këtë dhurim, sipas kushteve dhe termave të vendosura në këtë kontratë.
3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate Dhurimi Pasuri e Luajtshme (kuota) dhe depozitimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Pranuesi i Dhurimit, ANJA CHRISTINA SCHRADER do të jetë ortak i Shoqëria Franz und Charly Sh.p.k. zotëruar i një kuote me vlerë 3.750.000 (tremilion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Pranuesi i Dhurimit do të ketë dy ortakë:
  1. Henryk Egetemayer zotëruar i një kuote me vlerë 3.750.000 (tremilion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



A2024054320033453572

2.ANJA CHRISTINA SCHRADER zotërues i një kuote me vlerë 3.750.000 (tremilion e shtateqind e pesedhjetë mijë) Lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë

## NENI 2 OBJEKTI I KONTRATËS

Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, Pala Dhuruese, pa kundërshtim, nëpërmjet dhurimit të kuotave sipas nenit 1.1., kalon 50% të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia e kuotave në shoqërinë Franz und Charly Sh.p.k. si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje në drejtim të Pranuesit të Dhurimit, duke i bërë të ditur këtij të fundit çdo detyrim apo kufizim që lidhet me këtë dhurim kuote, duke garantuar plotësisht titullin e pronësisë të pa rënduar me ndonjë barrë siguruese.

## NENI 3 KALIMI I PRONËSISË SË LIGJSHME MBI KUOTAT

3.1. Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Pala Dhuruese në favor të Pranuesit të Dhurimit do të kryhet pa kundërshtim, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate Dhurimi nga palët dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3.2. Pala Dhuruese zhvishet pjesërisht (50%) nga pronësia me të gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia e kuotave në shoqërinë Franz und Charly Sh.p.k.

## NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1. Pala Dhuruese i ka shpjeguar Pranuesit të Dhurimit gjendjen fizike dhe financiare të shoqërisë Franz und Charly Sh.p.k., e ka njohur atë me të gjithë dokumentacionin e shoqërisë si dhe me të gjithë të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër.

4.2. Pasi është njohur me të gjithë dokumentacionin, gjendjen fizike dhe financiare të shoqërisë Franz und Charly Sh.p.k., Pranuesi i Dhurimit është dakort të pranojë dhurimin e kuotës me vlerë 3.750.000 (tremilion e shtateqind e pesedhjetë mijë) Lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë Franz und Charly Sh.p.k. në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

4.3. Pala Dhuruese i siguron Pranuesit të Dhurimit se kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë objekt i kësaj kontrate, janë të lira nga çdo pretendim apo e drejtë e personave të tretë dhe është përgjegjës për çdo të metë të pronës që ekziston në çastin e kalimit të pronësisë.

4.4. Regjistrimi i kalimit të kuotës nga Pala Dhuruese tek Pranuesi i Dhurimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga Palët. Kjo kontratë duhet të depozitohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me qëllim reflektimin e ndryshimeve të strukturës së ortakëve në shoqërinë Franz und Charly Sh.p.k..

## NENI 5 LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontratë Dhurimi mbështetet në :

1. Nenin 761 e vijues të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë,
2. Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar,
3. Ligjit nr.8788 datë 07.05.2001 " për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar,
4. Ligji nr.131/2015 " për Qendrën Kombëtare të Biznesit,
5. Statutit dhe Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë Franz und Charly Sh.p.k.,
6. Statutit dhe Vendimit të Ortakut të vetem shoqërisë Franz und Charly "shpk,
7. Akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



A2024034320033453572

NENI 6  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët bien dakord që cdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi dhe ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes palëve. Në rast se bisedimet nuk japin rezultat atëherë konflikti do të zgjidhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni perkatës, Shqipëri.

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhr gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT

PALA DHURUESE  
HENRYK EGETEMAYER

*HENRYK EGETEMAYER*

PALA PRANUESE E DHURIMIT  
ANJA CHRISTINA SCHRADER

*Anja Christina Schrader*

NOTERE  
IRMA BROCI